



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada – Government  
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit  
Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta - Ministry of Culture, Youth and Sport



Nr: 68/2023

Datë: 27.01.2023

Duke u bazuar në nenin 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/01 mars 2019) si dhe pikën 8 (tetë) të Shtojcës I (një) të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, z. Feim Hoxha, nxjerrë:

#### V E N D I M

1. Formohet Komisioni për vlerësimin e aplikimeve, sipas thirrjes publike për OJQ për implementimin e projektit **“Konsultimi i të mbijetuarve dhe familjeve me fëmijë të vrarë gjatë luftës 1998-1999 në Kosovë”**, të datës 06.01.2023 -27.01.2023.

2. Komisioni ka këtë përbërje:

- 2.1. Drenushe Behluli-Mehmeti - kryesuese;
- 2.2. Egzontina Thaçi - anëtare;
- 2.3. Behar Mehmeti - anëtar;
- 2.4. Adem Lushaj, përfaqësues nga Shoqëria Civile – anëtar;
- 2.5. Përfaqësuesi i OJQ-se, anëtar;

3. Komisioni është i obliguar të bëjë vlerësimin e aplikimeve sipas kriterëve të përcaktuara në thirrjen publike për OJQ për implementimin e projektit **“Konsultimi i të mbijetuarve dhe familjeve me fëmijë të vrarë gjatë luftës 1998-1999 në Kosovë”**, të datës 06.01.2023 -27.01.2023.

4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Anëtarëve të Komisionit;
- Departamentit të Trashëgimisë Kulturore;
- Departamentit Ligjor;
- Arkivit të MKRS-së.

  
**Feim Hoxha**  
Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm